



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 364 Datë 15.12.2023

MBI
MIRATIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 10 dhe 31 të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe neneve 15të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/36 prot., datë 13.12.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024”,

Konstatoi se:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 23 Mars 2023 ka miratuar ligjin e ri nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017. Në nenin 10, pika 4 përcaktohet se: “Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW caktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE-ja në vitin 2016”.
- Gjithashtu në ë pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji përcaktohet se aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (Ligjit 24/2023).
- Me vendim VKM 687/2017, të ndryshuar, është miratuar metodologjinë e përcaktimit të “Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi ku ky çmim përllogaritet sipas formulës si vijon : çmimi vjetori i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në

euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 11 mujore të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2023, i cili rezulton në vlerën 109.39 Euro/MWh.
- Sipas metodologjisë, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2023. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i këmbimit për 11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2023 (Janar - Nëntor), rezulton të jetë 108.84 Lekë/euro.
- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike do të jetë 14.29 Lekë/kWh. Në zbatim të VKM nr. 687/2017 e ndryshuar, ky çmim rezulton të jetë mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në gërmën “d”, prej 10 lekë/kWh. Për rrjedhojë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024 do të jetë ai prej 10 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2024.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari

Petrit AHMETI